

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në TM1 2014 mund të konsiderohet se është karakterizuar me zhvillime relativisht të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përkundër rënies së lehtë si të eksporteve, ashtu edhe të importeve, deficitit tregtar ishte mjaft i përafërt me nivelin e TM1 2013. Në anën tjetër, kontributi i sektorit publik në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik u dobësua gjatë kësaj periudhe si pasojë e zvogëlimit të shpenzimeve publike. Sektori financiar vazhdoi të ketë rol të rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik dhe ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik të vendit. Kreditë e lëshuara nga sektori bankar vazhduan të rriten edhe gjatë TM1 2014 duke shënuar një rritje prej 2.4 përqind krahasuar me TM1 2013.

Depozitat vazhduan të jenë burim i qëndrueshëm i financimit të aktivitetit kreditor, duke shënuar rritje vjetore prej 7.1 përqind që mes tjerash reflekton nivel të lartë të besueshmërisë ndaj sistemit bankar. Si rezultat i kësajë, raporti kredi-depozita në TM1 2014 ishte 75.1 përqind krahasuar me 78.5 përqind në TM1 2013.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar i sektori bankar ka vazhduar të karakterizohet me zvogëlim të normave të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita.

Përkundër rritjes së lehtë të normës së kredive joperformuese, sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor. Në TM1 2014, raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive arriti në 8.6 përqind. Sektori bankar vazhdon të ketë pozitë të kënaqshme edhe për sa i përket nivelit të kapitalizimit dhe të likuiditetit.

Presionet inflacioniste gjatë TM1 2014 janë zbutur në masë të konsiderueshme. Në TM1 2014, norma e inflacionit ishte 0.2 përqind. Niveli i inflacionit në Kosovë vazhdon që në masë të madhe të reflektojë lëvizjen e çmimeve të importit.

Gjatë vitit 2014, projeksionet e BQK-së janë se norma reale e rritjes ekonomike do të jetë 4 përqind. Kjo rritje pritet të jetë e nxitur nga komponenta e sektorit privat si nëpërmjet konsumit ashtu edhe nëpërmjet investimeve. Sektori financiar gjatë vitit 2014 pritet të rrisë kontributin ndaj ekonomisë së vendit duke përshpejtuar ritmin e rritjes së kreditimit. Gjithashtu, edhe sektori i jashtëm pritet të ketë implikime pozitive për ekonominë vendore nëpërmjet pritjeve për rritje të mëtejme të eksporteve.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Ekonomia globale	04
Ekonomia e Kosovës	06
Sektori Real	06
Sistemi Financiar	08
Sektori Bankar	08
Kompanitë e Sigurimit	14
Fondet Pensionale	14
Institucionet Mikrofinanciare	15
Tregu i Bonove të Thesarit	16
Sektori Fiskal	16
Sektori i Jashtëm	17
GRAFIKËT DHE TABELAT	04
Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	04
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	05
Figura 3. Çmimi i arit për ounce	05
Figura 4. Çmimet e metaleve	06
Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 6. Norma e këmbimit e euros	07
Figura 7. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 8. Indekset e Çmimeve të Konsumit, prodhimit dhe importit	07
Figura 9. Regjistri i bizneseve	08
Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja	08
Figura 11. Asetet e bankave komerciale	09
Figura 12. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	09
Figura 13. Struktura e maturimit të kredive	
Figura 14. Struktura e maturimit të kredive të reja	10
Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	11
Figura 16. Kreditë sipas sektorëve të veçantë ekonomik	11
Figura 17. Mesatarja kuartale e normave të interesit	12
Figura 18. Normat mesatare kuartale të interesit për kredite e ndërmarrjeve	12

Figura 19. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ekonomive familjare	14
Figura 20. Normat mesatare kuartale të interesit për depozita.....	14
Figura 21. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale.....	12
Figura 22. Struktura e depozitave në bankat komerciale	14
Figura 23. Treguesit e profitabilitetit.....	15
Figura 24. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale	15
Figura 25. NPL dhe provizionet për humbjet nga kreditë	16
Figura 26. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese	17
Figura 27. Asetet e institucioneve mikrofinanciare	17
Figura 28. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë.....	19
Figura 29. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar.....	20
Figura 30. Remitencat	20
Figura 31. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve	19
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	20

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërfomuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Ekonomia Globale


Aktiviteti ekonomik në nivel global ka vazhduar të përforcohet gjatë vitit 2014, ndërsa projeksionet tregojnë se ky trend do të vazhdojë edhe në vitin 2015. Projeksionet e fundit të FMN-së tregojnë për rritje globale për 3.6 përqind për vitin 2014. Sidoqoftë, kjo rritje ekonomike mund të cënohet nga inflacioni i ulët që vazhdon të paraqes problem për vendet e eurozonës. Në nivel global, inflacioni gjatë vitit 2014 pritet të jetë në 3.5 përqind krahasuar me 3.6 sa ishte në vitin paraprak. Marrë parasysh projeksionet aktuale të inflacionit, pritjet janë se vendet e zhvilluara do të jetë bartëse për rritjen globale, ndërsa, vendet në zhvillim, përkundër përmirësimeve, ballafaqohen me rritje më të ngadalshme në krahasim me vitet e kaluara. (IMF WOE, 2014). Sidoqoftë, në rast të përshpejtimit të rënies së çmimeve, rritja për vitin 2014 mund të dobësohet, sidomos në vendet e zhvilluara.

Eurozona pritet që gjatë vitit 2014 të ketë rritje ekonomike prej 1.2 përqind. Sipas Bankës Qendrore Evropiane, projeksionet aktuale janë se çmimet gjatë vitit 2014 do të rriten me 1.5 përqind. Sidoqoftë, shqetësimet për rënie të mëtejme vazhdojnë të jenë të pranishme. Norma vjetore e inflacionit në eurozonë në TM1 2014 ishte 1.1 përqind, që paraqet normë më të ulët se caku i ECB-së. Për të evituar rënien e çmimeve, që mund të kalojë në deflacion, ECB ndryshoi edhe normën bazë të rifinancimit në nëntor të vitit 2013, ku kjo normë u zvogëluar në nivelin më të ulët historik duke arritur në vetëm 0.25 përqind. Ndryshimi i normës bazë të rifinancimit pritet të

lehtësojë kreditimin bankar dhe, rrjedhimisht, të stimulojë aktivitetin ekonomik.

Normat e interesit të kreditimit ndërbankar u karakterizuan me rritje të normave 1 mujore në mesatarisht 0.23 përqind në TM1 2014 nga 0.12 përqind në TM1 2013. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore u karakterizuan me rënie të lehtë nga mesatarisht 0.57 në TM1 2013 në 0.56 përqind në TM1 2014. Rritja e normës interesit së kreditimit ndërbankar gjatë kësaj periudhe deri në një masë i adresohet edhe hezitimit të bankave nga vendet kryesore të eurozonës për të kredituar bankat në vendet periferike.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së




Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

Rajoni i Evropës Juglindore (EJL) në përgjithësi u karakterizua me rritje solide ekonomike gjatë vitit 2013 dhe pritet të forcohet edhe më tej gjatë vitit 2014. Projeksionet për vitin 2014 sugjerojnë rritje mesatare prej 2.4 përqind për vendet e EJL-së. Kosova pritet të ketë rritjen më të lartë vjetore të PBB-së në kuadër të vendeve të EJL-së prej 4.0 përqind për vitin 2014. Norma e rritjes ekonomike pritet të jetë pozitive edhe në vendet tjera, duke përfshirë Maqedoninë dhe Malin e Zi me rritje prej

rreth 2.5 përkatësisht 2.7 përqind, Shqipërinë dhe Bosnje e Hercegovinën me rreth 2 përqind si dhe Serbinë me 1.3 përqind. Ndërsa, Koracia pritet të jetë vendi i vetëm në rajon që do të karakterizohet me rënie ekonomike (0.6 përqind).

Çmimet e naftës (brent crude)¹ në TM1 2014 shënuan rënie për rreth 4.4 përqind krahasuar me TM1 2013.

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulimet e BQK-së


Projeksionet aktuale sugjerojnë se çmimet e naftës në nivel global do të vazhdojnë të kenë tendencë rënëse, ndërsa arsyt kryesore konsiderohen të jenë rritja e kapaciteteve absorbuese të goditjeve nga ana e ofertës në vendet e zhvilluara si dhe vështirësitë në arritjen e marrëveshjes për zvogëlim të ofertës nga organizata e shteteve eksportuese të naftës, OPEC (*angl. Organization of Petroleum Exporting Countries*) (Bloomberg, 2014).

Rritja ekonomike globale pritet të përforcohet gjatë vitit 2014, bazuar kryesisht në rritjen e vendeve të zhvilluara. Sidoqoftë, rreziku nga deflacioni ka

vazhduar të paraqes shqetësim sidomos për rritjen në eurozonë.

Çmimet e arit gjatë TM1 2014 kanë shënuar rënie të theksuar në krahasim me TM1 2014, por se në krahasim me TM4 2013, çmimi ka filluar të rikuperohet. Projeksionet sugjerojnë se çmimi i arit do të vazhdojë të shënojë rënie të lehtë gjatë gjithë vitit 2014 (FMN, 2014).

Figura 3. Çmimi i arit për ounce




Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

Metalet tjera, me përjashtim të zinkut, kanë shënuar rënie të theksuar. Gjatë TM1 2014, krahasuar me TM1 2013, çmimet e aluminit kanë shënuar rënie vjetore prej 17.4 përqind. Këto lëvizje në çmimet e aluminit janë diktuar kryesisht si rezultat i ofertës së lartë në nivel global. Çmimi i plumbit ka shënuar rënie prej rreth 11.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 3). Zinku ka pasur rënie prej 3.9 përqind në TM1 2014 kundrejt TM1 2013, ndërsa në krahasim me tremujorin paraprak, ka pasur rritje për 4.8 përqind që është ndikuar nga oferta më e ulët gjatë këtij tremujori. Projeksionet e fundit të FMN-së sugjerojnë për rënie të çmimeve të metaleve gjatë vitit 2014.

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.


Figura 4. Çmimet e metaleve, në USD për ton



Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

Mallrat ushqimore gjatë TM1 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve kundrejt TM1 2013. Megjithatë, kryesisht si pasojë e pasigurive të shkaktuara nga kushtet klimatike në vendet prodhuese (sidomos SHBA) të mallrave kryesore si drithërat, çmimet e mallrave ushqimore ishin më të larta në TM1 2014 krahasuar me TM4 2013. Rënia e çmimeve të drithërave gjatë TM1 2014 kundrejt TM1 2013 ishte rreth 18.6 përqind, përderisa indeksi i përgjithshëm i mallrave ushqimore ishte më i ulët për rreth 2.7 përqind.

Figura 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAOUN (2014)

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë TM1 2014 ka pasur lëvizje të lehta.

Euro ndaj sterlinës britanike ka shënuar rënie për 1.6 përqind; ndaj frankës zvicerane ka shënuar rënie për 0.8 përqind; ndërsa, është përforcuar ndaj dollarit amerikan për 0.7 përqind.

Figura 6. Norma e këmbimit e Euros




Burimi: BQK (2014)

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Norma e rritjes ekonomike për vitin 2013, sipas BQK-së, vlerësohet të ketë qenë rreth 3.1 përqind që është për 0.6 pikë përqindje më e lartë se sa norma e rritjes ekonomike të shënuar në vitin paraprak. Në këtë kontekst, vlen të theksohet rritja e eksporteve dhe rënia e importeve e cila ka bërë që të përmirësohet deficitit tregtar. Gjatë vitit 2013, aktiviteti ekonomik në Kosovë është përkrahur edhe nga komponentat si remitencat dhe investimeve të huaja direkte, të cilat kanë pasur performancë të mirë si rezultat i rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara. Aktiviteti i sektorit privat është përkrahur edhe nga kreditë e sistemit bankar të cilat vazhduan normën pozitive të rritjes. Shpenzimet e qeveritare po ashtu shënuan rritje, por me normë më të ulët se sa në vitin paraprak, kryesisht për shkak të normës më të ulët të ekzekutimit të buxhetit.

Figura 7. Rritja reale e PBB-së, në përqindje




Burimi: ASK dhe BQK për vitet 2013 dhe 2014 (2014)

Edhe në vitin 2014, projeksionet tregojnë për rritje të aktivitetit ekonomik me një normë reale të rritjes së PBB-së prej rreth 4.0 përqind (figura 7).

Ky shtim i aktivitetit ekonomik pritet të gjenerohet kryesisht nga rritja e konsumit dhe eksporteve neto.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në TM1 2014 u karakterizua me rënie. Norma mesatare vjetore e inflacionit në TM1 2014 ishte 0.2 përqind krahasuar me normën prej 2.9 përqind në TM1 2013 (figura 8). Sa i përket komponentëve të CPI-së, rritje e çmimeve në TM1 2014 u shënuar kryesisht tek mjetet e komunikimit me 5.5 përqind, strehimi, uji, rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse me 3.7 përqind, restorantet dhe hotelet me 1.3 përqind. Ndërsa, rënie e çmimeve kryesisht u evidentua tek ushqimi dhe pijet joalkoolike me -1.4 përqind, pijet alkoolike dhe duhani me -1.7 përqind, veshmbathja me -6.5 përqind, transporti me -11.3 përqind.

Figura 8. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2014)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është mjaft e ngjashme me zhvillimet e çmimeve në nivel global si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe (figura 8). Indeksi i çmimeve të importit (angl: Import Price Index: IPI) deri në dhjetor 2013 është rritur mesatarisht për 0.2 përqind. Ndërsa, çmimet e prodhimit deri në dhjetor 2013 u karakterizuan me

rritje mesatare vjetore prej 2.5 përqind, rritje kjo e cila u nxit nga rritja e çmimeve të nxjerrjes së qymyrgurit, linjtit, mineraleve dhe produkteve të industrive tjera nxjerrëse.

Gjatë TM1 2014, në Kosovë u regjistruan 2,912 biznese të reja apo 189 biznese më pak se sa në TM1 2013, ndërsa u mbyllën 436 biznese apo 29 biznese më shumë se sa në TM1 2013 (figura 9). Të dhënat mbi bizneset e regjistruara vazhdojnë të jenë inkurajuese pasi që mbyllja e bizneseve ende ka raport të ulët ndaj bizneseve që hapen (1.5 biznese që mbyllen nga 10 sa hapen).


Figura 9. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2014)


Trendet sa i përket strukturës së ndërmarrjeve kanë vazhduar të jenë të ngjashme me vitin e kaluar, por se ky vit është karakterizuar me rritje të numrit të bizneseve të reja në tregti, hotele dhe restorante, dhe transport dhe telekomunikacion, ndërsa bujqësia dhe ndërtimtaria kanë shënuar rënie krahasuar me TM1 2013 (figura 10).

Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2014)

Figura 16. Kreditë sipas sektorëve të veçantë ekonomik, në përqindje (TM1 - 2014)




Burimi: BQK (2014)

Kreditë e destinuar për sektorët e prodhimit dhe shërbimeve financiare (patundshmëri, qera, etj.) u karakterizuan me rritje të lehtë të pjesëmarrjes ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet. Prodhimtaria rriti pjesëmarrjen në 11.9 përqind nga 10.6 përqind sa ishte në TM1 2013, nërsa shërbimet tjera financiare rritën pjesëmarrjen në 5.3 përqind nga 4.5 përqind sa ishin në TM1 2013. Rënie të lehtë të pjesëmarrjes në strukturë shënuan kreditë për tregti, ndërtimtari dhe bujqësi. Kreditë për tregti zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për ndërmarrje për 0.3 përqind, ato për ndërtimtari u zvogëluan për 1.3 përqind, ndërsa ato për bujqësi shënuan një zvogëlim vjetor për 0.1 përqind.

Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, norma efektive e interesit në kredi u zvogëlua në 11.6 përqind krahasuar me 13.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Figura 17).


Figura 17. Mesatarja kuartale e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Trendi i zhvillimit të normave mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve tregon se norma mesatare e interesit për kreditë investuese ka shënuar rënie (nga 12.8. përqind në TM1 2013 në 11.3 përqind në TM1 2014). Kjo rënie ishte nxitur kryesisht nga rënia e interesit në kreditë me maturim deri në një vit. Në anën tjetër, zhvillimi vjetor i normës mesatare të interesit në kreditë tjera biznesore ka pasur rënie më të theksuar (nga 14.7 përqind në TM1 2013 në 11.1 përqind në TM1 2014) (Figura 18).

Figura 18. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Tendeca rënëse vërehet edhe te kreditë për ekonomitë familjare, ku vërehet rënie më e theksuar për kreditë për blerje të shtëpive (9.9 përqind në TM1 2014 nga

11 përqind në TM1 2013) mirëpo edhe rënie ka shënuar edhe norma mesatare të interesit për kreditë konsumuese (11.7 përqind në TM1 2014 krahasuar me 12.5 përqind në TM1 2013) (Figura 19)


Figura 19. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind



Burimi: BQK (2014)

Norma mesatare e interesit në depozita në TM1 2014 u zvogëlua në 2.13 përqind, nga 3.61 përqind sa ishte në TM1 2013. Kjo rënie kryesisht i atribuohet rritjes së vazhdueshme të nivelit të likuiditetit në sektor.

Figura 20. Normat mesatare kuartale të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Rënia e vazhdueshme e normave të interesit në kreditë bankare është reflektuar në ngushtimin e dallimit ndërmjet normës së interesit në kredi dhe


depozita. Në TM1 2014, ky dallim u zvogëlua në 9.5 përqind, krahasuar me 9.6 përqind në TM1 2013.

Në përgjithësi, normat efektive të interesit në kredi dhe depozita, në TM1 2014, janë zvogëluar në krahasim me vitin paraprak, duke shkaktuar kështu një ngushtim të dallimit në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita. Gjithësesi rënia e normës së interesit në depozita ishte më e theksuar.

Depozitat

Gjatë tremujorit të parë të 2014, gjithsej depozitat në sistemin bankar arritën vlerën 2.43 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.1 përqind (8.7 përqind në TM1 2013) (Figura 21).

Figura 21. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2014)

Kontribues kryesor në rritjen e depozitave vazhduan të jenë depozitat e ekonomive familjare të cilat përfaqësojnë 73.7 përqind të gjithsej depozitave, dhe shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind. Në pjesën e mbetur hyjnë depozitat e ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 20.4 përqind, të cilat shënuan rritje vjetore prej 4.7 përqind, dhe depozitat tjera me pjesëmarrje prej 5.9 përqind të cilat shënuan rritje vjetore prej 15.2 përqind. Rritja e vazhdueshme e

depozitave në bankat komerciale tregon për një stabilitet të sektorit bankar.

Figura 22. Struktura e depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2014)

Profitabiliteti dhe Performanca

Sektori bankar u karakterizua me performancë pozitive gjatë TM1 2014, ku fitimi neto arriti në 9.8 milionë euro, duke shënuar kështu rritje vjetore prej 57.7 përqind. Rritja e profitit u reflektua edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 1.3 përqind, nga 0.9 përqind sa ishte në TM1 2013, kurse ROAE u përmirësua në 13.8 përqind, nga 9.4 përqind në TM1 2013 (Figura 23)².


Figura 23. Treguesit e profitabilitetit



Për 2014 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën gjatë TM1 2014
Burimi: BQK (2014)

Gjatë TM1 2014, të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar shënuan rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie ishte më e theksuar në anën e shpenzimeve, që rezultoi në rritjen e neto profitit bankar pavarësisht rënies së të hyrave. Rrjedhimisht edhe indikator i efikasitetit, që matë raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit u përmirësua dukshëm duke u zvogëluar në 81.7 përqind krahasuar 88.7 përqind në TM1 2013 (Figura 24).

Figura 24. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale



Burimi: BQK (2014)

Rënia e të hyrave prej 2.1 përqind ishte rezultat i rënies së të hyrave nga interesi që shënuan rënie vjetore prej 2.6 përqind. Të ardhurat nga jo-interesi


² ROAA dhe ROAE janë të analizuar me performancën e sektorit bankar deri në mars 2014

qëndruan në nivel të njëjtë. Ndërsa, në rënie e shpenzimeve prej 9.8 përqind, kontribues kryesor ishin shpenzimet e jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 18.4 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit lëvizjen kryesore e shënuan shpenzimet për provizione të cilat u zvogëluan për 29.3 përqind, ndërsa shpenzimet e përgjithshme dhe administrative u zvogëluan për 1.5 përqind. Shpenzimet e interesit në TM1 2014 shënuan rënie vjetore prej 15.3 përqind, duke dhënë kështu kontribut të lartë në rënie e gjithsej shpenzimeve.

Rënia më e theksuar e shpenzimeve të interesit krahas rënies së të hyrave nga interesi ka rezultuar në rritjen vjetore të neto të hyrave të interesit të sektorit për 3.7 përqind. Rënia në të hyrat nga interesi, ndër të tjerash, mund të jetë reflektim i uljes së normës së interesit në kredi krahasuar me vitet e kaluara dhe trendit të ngadalësuar të rritjes së kredive.

Në TM1 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë ka arritur në 8.6 përqind krahasuar me 7.6 përqind sa ishte në TM1 2013 (Figura 25). Edhe pse kemi rritje të kredive jo performuese për 1 pikë përqindje, trendi rritës i tyre është në rënie. Norma e rritjes vjetore të vlerës së kredive jo performuese ishte 15.5 përqind në TM1 2014, krahasuar me 32.9 përqind në TM1 2013 (Figura 26). Rritja e ngadalësuar e kredive jo performuese ndër tjerash mund të jetë rezultat i ngadalësimit të kreditimit.


Figura 25. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë



Burimi: BQK (2014)

Kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Në TM1 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 114.6 përqind (115.5 përqind në TM1 2013).

Figura 26. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Sektori bankar ka përforcuar edhe më shumë nivelin e kapitalizimit gjatë TM1 2014, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 17.4 përqind nga 15.1 përqind sa ishte në TM1 2013. Përforcimi i kapitalizimit i atribuohet kryesisht përmirësimit të performancës së sektorit bankar në

saje të rritjes së profitit si dhe rritjes së kapitalit nga aksionarët si rezultat i kërkesave të reja të BQK-së.

Gjithashtu, gjatë TM1 2014 sektori bankar vijoi të mbajë nivel të lartë të likuiditetit. Raporti i kredive ndaj depozitave në TM1 2014 u zvogëlua në 75.1 përqind nga 78.6 përqind sa ishte në TM1 2013, duke forcuar edhe më tutje pozitën e likuiditetit. Indikator tjetër i rëndësishëm për qëndrueshmërinë bankare është raporti mes mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, i cili në mars 2014 qëndroi në 45.3 përqind. Me rregullore të BQK-së kërkohet që niveli minimal i raportit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të jetë 25 përqind. Ky është edhe një tjetër tregues për stabilitetin e sektorit bankar në vend.

Kompanitë e sigurimit

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në TM1 2014 shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind, duke arritur vlerën 132.2 milion euro. Në kuadër të gjithsej asetëve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 118.9 milion euro, ndërsa sigurimet e jetës 13.3 milion euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 18.4 milion euro, që krahasuar me TM1 2013, paraqet një rënie prej 12.9 përqind. Primet e sigurimeve jo-jetë kanë gjeneruar 17.8 milion euro, ndërsa ato të sigurimeve jetë kanë gjeneruar 654 mijë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara arriti në 7.0 milion euro, prej të cilave 4.1 milion janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Në TM1 2014, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 369 mijë euro, krahasuar me periudhën e

njëjtë të vitit paraparak kur kishte shënuar fitim prej 14.1 mijë euro. Në humbjen e shënuar gjatë TM1 2014 kryesisht kontribuan sigurimet jo-jetë të cilat dyfishuan humbjen në krahasim me vitin paraparak (347.8 mijë euro humbje në TM1 2014 krahasuar me 142.3 mijë euro humbje në TM1 2013) dhe sigurimet jetë të cilat në TM1 2014 shënuan humbje prej 21.2 mijë euro krahasuar me fitimin prej 156.4 mijë euro në TM1 2013.

Fondet pensionale

Asetet e sektorit pensional arritën vlerën prej 954.2 milion euro në TM1 2014, duke shënuar rritje vjetore prej 19.2 përqind. Struktura e asetëve të sektorit të pensioneve dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) i cili menaxhon 99.4 përqind të gjithsej asetëve, ndërsa pjesa e mbetur prej 0.6 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno–Kosovar i Pensioneve (FSKP).

FKPK vazhdoi trendin e rritjes së asetëve dhe kthimit neto nga investimet edhe në TM1 2014. Totali i asetëve të FKPK-së në TM1 2014 arriti vlerën prej 948.7 milion euro. Kthimi bruto prej 10 milion euro si dhe kontributet e reja që në TM1 2014 arritën vlerën prej 30.2 milion euro ishin kontribuesit kryesor në rritjen e mjeteve nën menaxhim të FKPK-së. Në ditën e fundit të marsit 2014 çmimi i aksionit arriti në 1.22 euro (1.16 euro në TM1 2013).


FSKP gjithashtu ndjeki trend pozitiv të rritjes së asetëve gjatë TM1 2014, të cilat arritën vlerën prej 5.5 milion euro nga 5 milion euro sa ishin në TM1 2013. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që arriti vlerën 0.5 milion euro (0.3 milion euro në

TM1 2013). Në ditën e fundit të marsit 2014, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 140.8 Euro.

Institucionet mikrofinanciare

Asetet e sektorit mikrofinanciar në fund të marsit 2014 shënuan rënie vjetore prej 1.5 përqind, duke arritur vlerën 111.4 milion euro.

Figura 27. Asetet e institucioneve mikrofinanciare (ndryshimet tremujore)



Burimi: BQK (2014)

Rënia kryesisht i atribuohet aktivitetit më të ngadalshëm kreditor. Në TM1 2014, gjithsej kreditë shënuan rënie vjetore prej 2 përqind, e cila është dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak (rënie vjetore prej 9.2 përqind në TM1 2013). Kreditë për biznese shënuan rënie vjetore prej 6.7 përqind, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 0.4 përqind. Në anën tjetër, lizingjet u karakterizuan me rritje vjetore prej 5.2 përqind. Lizingjet e destinuar për biznese shënuan rënie për 5.1 përqind, ndërsa ato për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje prej 39.3 përqind.

Mesatarja e normës efektive të interesit për kreditë e lëshuara nga institucionet mikrofinanciare gjatë TM1

2014 ka arritur në 24 përqind nga 23.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në TM1 të vitit 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë e institucioneve mikrofinanciare është zvogëluar në 5.8 përqind krahasuar me 6.6 përqind sa ishte në TM1 2013 (Figura 27). Kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë, ku në TM1 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 106.3 përqind (107.9 përqind në TM1 2013).

Në TM1 2014, sektori realizoi të hyra prej 4.6 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 12 përqind (5.3 milionë euro në TM1 2013). Sidoqoftë, shpenzimet shënuan rënie vjetore më të theksuar me një normë prej 15.5 përqind, duke ndikuar që sektori të ngushtojë humbjen në 0.2 milionë euro krahasuar me 0.5 milionë në TM1 2013. Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përkeqësuan në krahasim me vitin paraprak. ROAA u zvogëluar në (-0.9) përqind nga (-0.3) përqind sa ishte në TM4 2013, ndërsa ROAE u zvogëluar në (-3.2) përqind nga (-1.1) përqind sa ishte në TM4 2013³.


Gjatë TM1 2014, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës vazhdoi të shënoj rritje të aseteve dhe kthim pozitiv neto të investimeve. Gjithashtu, edhe sektori i sigurimeve ka shënuar rritje të aseteve. Ndërsa sektori mikrofinanciar ka vazhduar të zvogëloj aktivitetin financiar mirëpo me normë më të ngadalëshme.

³ ROAA dhe ROAE për vitin 2014 janë të analizuar me performancën e sektorit deri në mars 2014

Tregu i Bonove të Thesarit

Deri në mars 2014, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka pasur gjithsej 6 ankande, prej të cilave 1 me afat maturimi 91 ditë, 3 ankande për periudhë maturimi 182 ditë dhe 1 ankand për afat maturimi 364 ditë. Gjithashtu në mars 2014, për herë të parë u emetua një fletëobligacion qeveritar dy vjeçar. Krahasuar me vitin paraprak, vërehet një zhvendosje e ofertimit prej akterëve primar nga letrat me vlerë afatshkurtëra në drejtim të atyre më afatgjata.

Figura 28. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumata e ofertuara për 91 ditë.
Burimi: BQK (2014)

Norma së interesit në letrat me vlerë 182 ditëshe u zvogëlu 1 përqind TM1 2014, krahasuar me 1.25 përqind në vitin paraprak. Kjo rënie është kryesisht rezultat i tejkalimit të vazhdueshëm të kërkesës së thesarit, në letrat me vlerë afatgjata nga oferta e akterëve primar. Përkundër ofertimi më të ulët në letrat me vlerë afatshkurtëra edhe kjo kategori u karakterizua me rënie të normës së interesit (0.5 përqind TM1 2014 krahasuar me 0.8 përqind në vitin paraprak). Në anën tjetër, norma e interesit për letrat me vlerë me afat maturimi 364 ditë ishte 1.37 përqind, ndërsa norma e interesit për fletëobligacionin qeveritar dy vjeçar ishte 2.4 përqind.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore neto në TM1 2014 shënuan rritje vjetore prej 0.9 përqind duke arritur në 273.1 milionë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në 254.7 milionë euro që paraqet rënie vjetore prej 9.0 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës në TM1 2014 regjistroi suficit prej 18.4 milionë euro. Ekzekutimi i shpenzimeve të planifikuara deri në mars 2014 arriti në mbi 16 përqind të planit për vitin 2014, ndërkohë që realizimi i të hyrave buxhetore ishte më i lartë se sa i shpenzimeve duke arritur në rreth 19 përqind të planit për vitin 2014.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, është shënuar rritje e të hyrave të mbledhura në kufi të cilat shënuan rritje vjetore prej 12.1 përqind dhe kanë arritur nivelin bruto prej 165.5 milionë euro. Rritja e të hyrave të mbledhura në kufi, deri në një masë, reflekton rritjen e kontrolleve në të gjitha pikëkalimet kufitare dhe përmirësimin e kualitetit të vlerësimit të mallrave me rastin e zhdoganimit të tyre. Përveç të hyrave të mbledhura në kufi, edhe të hyrat vendore kanë shënuar rritje prej 2.9 përqind dhe kanë arritur nivelin bruto prej 75.0 milionë euro. Kjo rritje e të hyrave vendore është rezultat i ngritjes së efikasitetit të ATK-së në mbledhjen e të hyrave dhe lehtësimit të procedurave për deklarimin dhe pagesën e obligimeve tatimore por edhe i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend.

Sa i përket shpenzimeve, të gjitha kategoritë shënuan rënie në TM1 2014 krahasuar me TM1 2013, me përjashtim të pagave dhe mëditjeve të cilat shënuan

rritje nga 69.6 milionë euro në 105.3 milionë euro në TM1 2014 (41.2 përqind e gjithsej shpenzimeve krahasuar me 24.8 përqind të gjithsej shpenzimeve në TM1 2013). Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 14 përqind dhe kanë shënuar vlerën 32.6 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rënie prej 11 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 70.8 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për investime kapitale në TM1 2014 kanë shënuar vlerën prej 39.8 milionë euro krahasuar me 87.9 milionë euro në TM1 2013. Rënia e theksuar e kategorisë së investimeve kapitale i adresohet përfundimit të projektit të autostradës, komponentë kjo që në TM1 2013 ka qenë në implementim e sipër.

Sektori i Jashtëm


Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë është përmirësuar në vitin 2013, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të vazhdueshëm të deficitit në llogarinë rrjedhëse. Në vitin 2013, llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 339.4 milion euro, që paraqet një rënie vjetore prej 10.7 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse zbriti në nivelin më të ulët të shënuar në vitet e fundit në rreth 6.6 përqind të PBB-së në vitin 2013 (7.7 përqind të PBB-së në vitin 2012). Deficiti në llogarinë rrjedhëse kryesisht i atribuohet deficitit tregtar.

Në TM1 2014 deficitit tregtar u rritë për 0.2 përqind duke arritur në 425 milion euro krahasuar me TM1 2013. Kjo rritje erdhi si pasojë e rënies më të shpejtë

të vlerës së eksporteve krahasuar me vlerën e gjithsej importeve.

Vlera e gjithsej eksporteve në TM1 2014 është karakterizuar me një rënie vjetore prej 2.3 përqind, duke zbritur në 65.7 milionë euro. Rënia e eksporteve në TM1 2014 kryesisht i atribuohet rënies së çmimeve të metaleve bazë në tregjet ndërkombëtare.

Figura 29. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2014)

Në të njëjtën periudhë, importet u karakterizuan me rënie prej 0.1 përqind, duke arritur vlerën prej 490.7 milionë euro. Si pasojë e rënies së vlerës së eksporteve në TM1 2014, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u zvogëlua nga 13.7 përqind në TM1 2013 në 13.4 përqind në TM1 2014.

Një ndër kategoritë më të rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave në Kosovë që vazhdon të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse mbeten remitencat. Deri në dhjetor 2013, remitencat arritën vlerën prej 620.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.6 përqind (figura 29).


Figura 30. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Vlera e gjithsej IHD-ve arriti në 258.9 milionë euro në dhjetor 2013, që paraqet rritje vjetore prej 13.2 përqind. Kjo rritje e IHD-ve është gjeneruar kryesisht nga fitimi i riinvestuar i kompanive që operojnë në Kosovë, i cili ka shënuar rritje prej 56.9 përqind duke arritur vlerën prej 71.6 milionë euro. Gjithashtu, me rritje vjetore u karakterizuan edhe investimet tjera, që kryesisht janë kredi ndërmjet kompanive. Investimet e tjera në kuadër të IHD-ve arritën vlerën prej 90.7 milionë euro në fund të vitit 2013 nga 26.4 milion sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kapitali aksionar, i cili në strukturën e IHD-ve ka pjesëmarrjen më të madhe, është zvogëluar në 96.6 milion euro në vitin 2013, nga 157.1 milionë euro në vitin 2012 (figura 31).

Figura 31. Strukturat e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Në vitin 2013, struktura e IHD-ve ishte kryesisht e koncentruar në sektorin e patundshmërisë (35.4 përqind), ndërtimitarisë (15.1 përqind), transportit dhe telekomunikacionit (14.2 përqind) si dhe sektorin e shërbimeve financiare (11.0 përqind). Sa i përket origjinës së IHD-ve në Kosovë, shtetet të cilat kanë realizuar pjesën më të madhe të investimeve në Kosovë mbeten Turqia me 86.8 milionë euro, pasuar nga Zvicra me 41.7 milionë euro, Gjermania 21.7 milionë euro dhe Shqipëria me 20.5 milionë euro.

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2014): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 6 TM1 2014, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2014):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2014):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në maj 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në maj 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në maj 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në maj 2014: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në maj 2014: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2014): Metal Prices database, qasur në maj 2014.

FAOUN (2014): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në maj 2014:
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2014): Euribor Historical Rates, qasur në maj 2014:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2014): World Economic Outlook: qasur në maj 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Mars 2013	Mars 2014
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	2.8%	1.1%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	2.6%	0.3%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	292.6	273.1
Shpenzimet (në milionë euro)	280.0	254.7
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-	-
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	3,884.1	4,258.9
prej të cilave: Bankat	2,835.7	3,053.3
Kredi	1,782.7	1,825.9
Depozita	2,269.4	2,430.8
Norma e interesit në kredi	12.6	11.2
Norma e interesit në depozita	3.5	1.7
Hendeku i normës së interesit	9.1	9.5
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-380.2	-339.4
prej të cilave: remitencat	605.1	620.8
Llogaria financiare	130.3	133.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	213.3	241.0
Investimet portfolio, net	-184.9	-133.8
Investimet tjera, net	369.2	5.1
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	248.8	387.0
Asetet	3,705.1	4,083.4
Detyrimet	3,456.3	3,696.4
Borgji i jashtëm, gjithsej	1,517.3	1,594.3
Borgji i jashtëm privat	1,115.9	1,210.4
Borgji i jashtëm publik	401.4	383.9

Burimi:

1/ ASK (2014).

2/ MF (2014).

3/ BQK (2014).

